




USAID
NGA POPULLI AMERIKAN
OD AMERIČKOG NARODA



Çmimi më i ulët i poentuar nuk është kontrata me çmimin më të lirë



Çmimi më i ulët i poentuar nuk është kontrata me çmimin më të lirë

Autor: **Agon Hysaj**

Shtator 2021

Kjo analizë e shkurtër është përgatitur nga Demokraci Plus (D+) dhe mbështetur nga USAID përmes aktivitetit Komuna Transparente, Efektive dhe Llogaridhënëse (USAID TEAM). Qëndrimet e autorit të shprehura në këtë raport nuk pasqyrojnë medoemos pikëpamjet e Agjencisë së Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID) ose qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

Procedura e poentimit të çmimit është një procedurë e cila përdoret në prokurimin publik për rastet kur autoriteti kontraktues “nuk e di” sasinë e artikujve që do të porosisë, dhe për këtë qëllim secili artikull në listë të çmimeve e ka sasinë “1”. Gjatë zbatimit të kontratës porositë bëhen varësisht prej nevojave që dalin. Lista e çmimeve ndahet në disa kategori dhe secilës prej tyre iu jepet një peshë e caktuar në totalin prej 100%. Poentimi i çmimeve shërben vetëm për të vlerësuar ofertat, ndërsa kontrata zbatohet me çmimet për njësi.

Komuna e Prizrenit është ndër komunat që më së shpeshti e përdor këtë lloj procedure. Në rregulloret e mëhershme përdorimi i kësaj procedure nuk ka qenë i lejuar për tenderët për ekzekutim të punëve. Në vitin 2019, KRPP lejoi që kjo lloj procedure të mund të përdoret edhe për tenderë të ekzekutimit të punëve. Përlllogaritja e sasive merr kohë, prandaj duket se për komunën e Prizrenit është më lehtë që të vendosë për përdorim të procedurës së poentimit të çmimit sesa të përdorë procedurat tjera që mund të jenë më të komplikuar por që ndikojnë në ruajtjen e parasë publike. Në këtë mënyrë, komuna rrezikon që të paguajë më shumë duke pranuar çmime [manipuluese](#).

Më 17 maj 2021, përmes procedurës së poentimit të çmimit, Komuna e Prizrenit ka lidhur kontratë me kompaninë NBT-ING SH.P.K për tenderin “Rregullimi - rehabilitimi i korridoreve në objektet e banimit kolektiv me participim”. Çmimi i poentuar me të cilin është lidhur kontrata është 3.86 euro, ndërsa çmimi i papoentuar në bazë të cilit do të kryhen pagesat është 21.60 euro. Kontrata është e tipit kontratë kornizë për 12 muaj. Vlera e parashikuar e tenderit ka qenë 100,000 euro, të cilës i shtohet edhe pjesa e participimit të qytetarëve, e cila nuk është paraqitur në kontratë. E veçanta e kësaj procedure është se nuk mund të përdoret kufizimi prej plus/minus 30% i vlerës së kontratës, por kontrata realizohet për aq sa ka mjete të parashikuara për këtë tender. Rregullat për kontratën kornizë nuk specifikojnë minimumin e porosive që duhet të bëhen, që nënkupton se jodomsdoshmërisht duhet të shpenzohen të gjitha mjetet e parashikuara.

Përveç NBT-ING në këtë tender kanë ofertuar edhe gjashtë operatorë tjerë ekonomik, pesë prej të cilëve u shpallën të papërgjegjshëm për mosplotësim të kriterëve dhe një u cilësua i përgjegjshëm, por me çmim më të lartë se NBT-ING. Në fakt oferta e NBT-ING kishte çmimin më të ulët të poentuar se të gjithë OE tjerë.

Nr.	Emri dhe adresa e Operatorit Ekonomik	Vlera e ofertës
1.	Alboss SH.P.K.	6.98
2.	Bajram HA.GASHI B.I. & Gashi ING	5.72
3.	NBT-ING SH.P.K.	3.86
4.	Megrant ING SH.P.K. & Risamont SH.P.K.	7.32
5.	Limit L&B SH.P.K & NPN EUROING SH.P.K.	11.96
6.	A & F Projekt SH.P.K.	45.79
7.	MBB Construction SH.P.K.	4.92

Tabela 1: Çmimet e ofertave në tenderin “Rregullimi - rehabilitimi i korridoreve në objektet e banimit kolektiv me participim”

Në dosje të tenderit nuk është specifikuar numri i banesave ku do të ketë renovim. Mos specifikimi i lokacionit dhe detaje tjera ka mundur të ndikojë që OE të caktuar të marrin informacion nga brenda Komunës dhe të jenë në avantazh ndaj OE tjerë. Këtë gjë Komuna e Prizrenit e ka bërë edhe në tenderin për furnizim me zhavorr, ku as aty nuk ka specifikuar se në cilat rrugë do të shtrohet zhavorri. Mangësia në informacion dhe përdorimi i procedurës së poentimit të çmimit ka bërë që të ketë dallime të mëdha në çmime të operatorëve ekonomik. Për shembull dallimi në çmimin e poentuar në mes të ofertës më të lirë dhe më të shtrenjtë është mbi dhjetëfish.

Procedura e poentimit të çmimit po ju jep mundësi operatorëve ekonomik që të vendosin çmime të larta në artikujt që ata mendojnë që do të porositen dhe çmime jonormalisht të ulëta në artikujt që ata mendojnë që nuk do të porositen. Në këtë mënyrë edhe pse çmimi i poentuar i tenderit mund të jetë shumë i ulët, operatori ekonomik prapë arrin profitin. Edhe në këtë tender ka ndodhur njëjtë sikurse në tenderin për furnizim me zhavorr, të dy të shpallur nga Komuna e Prizrenit.

Në artikullin B.2: “Furnizimi, transporti dhe ngjyrosja e plafonëve me ngjyrë disperzive (akril). Para ngjyrosjes të lyhet edhe shtresa bazë. Në çmim të llogariten tri shtresa të lyerjes”, NBT-ING ka dhënë çmim 0.30 euro për metër katror. Ky lloj shërbimi në treg minimalisht kushton 2.50 euro.¹

Në artikullin B.3: “Furnizimi, transporti dhe ngjyrosja e mureve me ngjyrë të yndyrshme. Para ngjyrosjes të lyhet edhe shtresa bazë. Në çmim të llogariten tri shtresa të lyerjes”, NBT-ING ka dhënë çmim 0.70 euro për metër katror. Ky lloj shërbimi është një nga më të zakonshmit në treg dhe i cili kushton së paku 2.50 euro për metër katrorë².

Për të dy artikujt më lartë ka çmime të ndryshme në ofertat e OE tjerë. Për shembull për artikullin B.3 kompania MBB Construction ka dhënë çmim 0.01 euro, ndërsa A&F Projekt, 8.20 euro. Kjo tregon që procedura e poentimit të çmimit jep mundësi të mëdha që të ketë manipulime gjatë ekzekutimit të kontratës. Secili OE “mundohet” të ja qëllojë se cilin artikull do ta porosisë komuna.

Prandaj çmimi më i ulët i peshuar nuk do të thotë patjetër që do të jetë oferta me çmimin më të lirë. Oferta e NBT-ING është 21.60 euro e papoentuar, ndërsa Limit L&B SH.P.K & NPN EUROING SH.P.K ka çmim të papoentuar prej 14.10 euro apo 35% më lirë. Vlen të theksohet se ky konsorcium ka gabuar në llogaritjet e çmimi te poentuar. Çmimi i poentuar i dorëzuar në ofertë është 11.96 euro, mirëpo do të duhej të ishte 2.96 euro. OE ka gabuar në llogaritjet e çmimi të poentuar për pjesën C të paramasës e cila ka pasur peshë 10%. OE për këtë pjesë ka dhënë çmim 10.30 euro, ndërsa për çmimin e poentuar është dashur të vendosë 1.30 euro ($10.30 * 10\%$), por e ka vendosur çmimin e njëjtë, 10.30 euro. Me çmimin prej 2.96 euro ky konsorcium do ta kishte ofertën më të lirë, mirëpo është eliminuar për arsye se nuk ka dorëzuar Deklaratën Tatimore nga Administrata Tatimore e Kosovës (ATK) për muajin dhjetor 2020. Megjithatë sipas Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurim Publik, Komuna ka mundur ta kërkojë këtë dokument, por nuk e ka bërë një gjë të tillë. Gabimi në çmim nuk është vërejtur nga komisioni i vlerësimit, i cili është një lëshim i madh nga ana e tyre. Për të evituar këtë, Komuna e Prizrenit duhet të ndërtojë paramasën me formula dhe kuti të mbrojtura, ku të gjitha çmimet llogariten në mënyrë automatike. Kjo do të bënte punën më të lehtë edhe për komisionin e vlerësimit dhe për operatorët ekonomik.

Oferta tjetër e konsorciumit Bajram HA.GASHI B.I. & Gashi ING e ka çmimin e papoentuar 14.45 euro apo 33% më lirë. Pra dy OE kanë çmim të papoentuar më të ulët se oferta e NBT-ING. Megjithatë shikuar nga çmimet që ka vendosur NBT-ING në dy artikuj, të cilat janë çmime jonormalisht të ulëta, atëherë edhe dy OE tjerë kanë çmime të tilla, por jo tek të njëjtit artikuj. Psh, çmimin për artikullin C.2, “Furnizimi me material dhe ndërrimi i ndriçuesve të dëmtuar nga xhami i bardhë i kromuar, 40w”, NBT-ING e ka pesë euro, ndërsa Bajram HA.GASHI B.I. & Gashi ING, 0.10 euro.

Sa i përket ekzekutimit të kontratës, Komuna e Prizrenit deri më 10 shtator 2021 ka paguar vetëm një faturë me vlerë 29,884.84 euro. Sikur edhe në shumë tenderë tjerë, që tashmë është

¹ Hulumtim i tregut zhvilluar në shtator 2021. Janë pyetur tre operatorë ekonomik të ndryshëm

² Po aty.

bërë dukuri, Urdhërblerja tek NBT-ING është dërguar pasi kanë përfunduar të gjitha punët, ndërsa do të duhej të ndodhte e kundërta. Urdhërblerja është dashur të dërgohet pas nënshkrimit të kontratës. Pasi kjo kontratë është kontratë kornizë atëherë afati për kryerjen e punëve matet me datën e dërgimit të urdhërblerjes. Në këtë rast afati është tre ditë, por që nuk mund të matet.

Deri në korrik 2021 kryerja e punëve është bërë në 10 ndërtesa. Dy pjesë të faturës me vlerë, 1,604.58 euro janë të njëjta. Sipas situacionit punimet janë kryer në rrugën Remzi Ademaj. Njëri lokacion nuk ka emër të ndërtesës, ndërsa tjetri Remzi Ademaj L2/H12. Të gjitha pozicionet në paramasë kanë sasi të njëjtë për të dy lokacionet. Kjo mund të jetë ndërtesë e njëjtë me dy hyrje, mirëpo nuk mund të kenë nivel të njëjtë të punës përgatitore në pozicionin A.1 të paramasës që ka të bëjë më pastrimin e mureve më gërryerje dhe arnimin e pjesëve të dëmtuara. Pjesa e dytë e këtij përshkrimi nënkupton që të dy hyrjet e banesës të kenë nivel të njëjtë të pjesëve të dëmtuara.

Deri më tani për kategorinë A.1, të cilit komuna i ka dhënë peshë 20% me rastin e poentimit të çmimit janë shpenzuar 14,003 euro. Sipas një interpretimi nga KRPP te Pyetjet e Shpeshta nr. 68, autoriteti kontraktues gjatë ezekutimit të kontratës duhet që³:

*Pra Autoritetet Kontraktuese duhet të luajnë një rol aktiv në përcaktimin sa më të saktë të vlerës së parashikuar e me këtë edhe vlerës së kontratës (të realizuar). Duke pasur parasysh faktin se peshimi i artikujve duhet bërë bazuar në peshën dhe në rëndësinë e kategorisë përkatëse, kjo nënkupton që edhe sasia e realizuar (shpenzuar) **nuk mund** dhe nuk duhet të ndryshojë nga raportet sipas peshës së dhënë. P.sh nëse pesha është dhënë kategorive të artikujve apo shërbimeve duke u bazuar në raportet sasiore/rëndësinë e kategorisë ndërmjet tyre, atëherë edhe shpenzimet për kategori duhet të ruajnë të njëjtin raport.*

Sipas këtij interpretimi, Komuna e Prizrenit për këtë kontratë, për kategorinë A të paramasës mund të shpenzojë maksimum 20,000 euro pasi vlera e parashikuar e kontratës është 100,000 euro dhe pesha e kësaj kategorie është 20%. Duke marrë parasysh që deri më tani është realizuar rreth 30% të kontratës dhe duke marrë parasysh që pozicioni A.1 është i nevojshëm në çdo punë (pasi nuk mund të ketë lyerje/renovim pa bërë punët përgatitore) atëherë komuna do ta tejkalojë këtë vlerë deri në përfundim të kontratës.

Për të evituar mundësinë për keqpërdorime, Komuna e Prizrenit, duhet që në të ardhmen të mos përdorë procedurën me poentim të çmimit. Në rastin e këtij tenderi shumë lehtë ka mundur të bëjë matjen e mureve dhe plafonëve dhe të japë sasinë indikative në paramasë. Pikërisht në këtë tender ka qenë e mundur që të jepet një sasi indikative e produkteve dhe pastaj të mund të përdoret kufiri prej plus 30% në rast që komuna do të kishte nevojë për punë shtesë.

³ Komisioni Rregullativ për Prokurim Publik. Pyetjet e Shpeshta nr. 68. 2019. <https://e-prokurimi.rks-gov.net/Home/ClanakItemNew.aspx?id=268>



USAID
NGA POPULLI AMERIKAN
OD AMERIČKOG NARODA

